



# INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

## Përmbledhje mujore e aktiviteteve nga IPK – Maj 2026

### Menaxhimi i ankesave

IPK gjatë muajit Maj 2026 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 181 ankesa. Prej tyre 139 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës në Policinë e Kosovës, disa janë përcjellë në institucione tjera kurse 42 nga to janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve në IPK më dyshimin për veprimtari penale.

	Gjithsej	Për javë	Për ditë
Numri i ankesave	181	45	6

### Aktivitete në fushën e hetimeve

Bazuar në mandatin e paraparë me legjislacionin në fuqi, IPK kryen hetime penale dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë. Gjatë muajit Maj 2026 Departamenti i Hetimeve në IPK ka pranuar 42 raste për hetim penal dhe në kuadër të autorizimeve ligjore ka dhënë rekomandimin për suspendim në interes të hetimit për 6 punonjës të Policisë së Kosovës dhe ka arrestuar 3 të dyshuar.

Aktivitetet e këtij Departamenti janë shprehur në mënyrë tabelore si në vijim:

Indikatori (numri)	Të dhëna për muajin Maj 2026
Kallëzime penale të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	5
Raporte të veçanta të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	5
Raporte informuese të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	6
Raste të proceduara në DHB, DPP-PK dhe Arkiv-IPK	34
Rekomandime për suspendim	6
Të arrestuar	3

### Aktivitete në fushën e inspektimit

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese. Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore përmes inspektimeve.

Gjatë muajit Maj 2026 inspektorët e IPK-së kanë qenë të angazhuar në këto inspektime:

Fusha e inspektimit	Lloji	Statusi
Menaxhimi i Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor të Rahovecit	Jashtëzakonshëm	Në proces
Kompensimet për orët jashtë orarit të rregullt të punës	Jashtëzakonshëm	Në proces
Vlerësimi i performancës së stacioneve policore	I rregullt	Në proces